

## STATUTI I SHOQERISE MONDO GROUP ALBANIA shpk

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar Sh.p.k.MONDO GROUP ALBANIA eshte krijuar sot me date 10.01.2022 sipas Statutit te perpiluar dhe nenshkruar nga ortaket themelues :

- 1.Z.Enea Gjafa i biri I Arbenit ,i datelindjes 05.09.1997** shtetas shqipetar ,lindur dhe banues ne TIRANE, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Nr Personal **J70905067F**.
- 2. .Z.Enzo Mattia i biri i Cristianos ,i datelindjes** shtetas italian ,lindur dhe banues ne Itali , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Nr Personal te pasaportes **YB6162558**.
- 3. Z. Sadik Bulbul i biri i Halitit ,i datelindjes 25.08.1969,** shtetas Turk ,lindur dhe banues ne TURQI, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me Nr Personal **U 20756410**.
- 4. Z. Orhan Isikli i biri i Tevfikut,i datelindjes 22.05.1978,** shtetas Turk ,lindur dhe banues ne TURQI, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me Nr Personal **U 20756410**.

Ne cilesine e "Ortakeve themelues te shoqerise " Shpk, me vullnet te lire, te plote e te sinqerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtarete dhe shoqerite tregtare", ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Bisnesit ", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin Shpk. (me poshte e quajtur "Shoqeria")

### *KREUI*

#### Neni 1

##### *Krijimi*

**Shoqeria MONDO GROUP ALBANIA shpk** ., eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

#### Neni 2

##### *Personaliteti juridik*

Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne QKB.

Kontributi i ortakeve perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Ortaket gezojne secili kuoten e vet ne shoqeri, ne perpjesetim me kontributin qe ka dhene ne kapital.

#### Neni

##### *3 Selia*

**Shoqeria e ka seline ne : Tirane -rruga Mine Peza ,Zona Kadastrale Nr 8350 me numur pasurie Nr.1/162+3-18/1. Pallat Nr.194 Sh3K 1 Ap. Nr.18**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese se pergjithshme.

#### Neni 4

##### *Objekti i veprimtarise :*

**Import, eksport ,tregtim i mallrave ushqimore,industrial ,bujqesore, materialeve te ndertimit ,elektroshtepiakeve dhe paisjeve kompjuterike,te gomave dhe pjeseve te lembimit te automjeteve, automjete dhe makineri ndertimi te perdorura dhenja me qera e makinerive dhe skelerive te ndertim.**

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

*KREU II*

*KAP/TALI*

Neni 6

Kapitali theme/tar

**Kapitali themeltar i shoqerise eshte 150.000 leke, me vlere nominale 150.000 leke. Kuotat e kapitalit themeltar zoterohen 100% te kapitalit me 100 ( njeqind ) kuote nga ortaket:**

1. ENEA GJATA me 25 kuota me 25 % = ( 37.500 )leke
2. ENZO MATTINI me 25 kuota me 25% = ( 37.500 )leke
3. SADIK BULBUL me 25 kuota me 25 % = ( 37.500 )leke
4. ORHAN ISIKLI me 25 kuota me 25 % = ( 37.500 )leke

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme. Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta)

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme duke kotnribuar ne para ose me ane te kontributeve ne natyre, dhe ne sherbime,si dhe nga fitimet e shoqerise .

Zvogelimi i kapitalit themeltar ne nje vlere me te vogel se ajo e percaktuar ne nenin 6 te ketij statuti, e ben te detyrueshme marrjen e nje vendimi prej shoqerise per zmadhimin e kapitalit themeltar te pakten deri ne vleren minimale.

Ne rast moszbatimi te kerkesave te ketij paragarfi , çdo person i interesuar mund te kerkoje ne rruge gjyqesore prishjen e shoqerise. Kjo prishje nuk mund te shpallet, ne qofte se rregullimi eshte here ne ditën kur gjykata mblidhet per te marre vendim.

Neni 8.

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- 9) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### *KREU III*

#### *ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE*

##### *Neni 9*

##### *Organi Vendimmarres*

Asambleja e Pergjithshme eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

*Asambleja e Pergjithshme, vendos per çeshtje si :*

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te regjistruar;
- 9) percaktimin e shperblimeve
- d) mbiqerjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga asambleja e pergjithshme regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shpendarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- 9) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- d) thirrjen e mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne haze te rrethanave te qarta . nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

##### *Neni 10*

##### *Administrimi*

Administrator i shoqerise eshte **Z.Enea GJATA**, emeruar ne kete detyre per nje afat 5 vjecar me te drejte ripeteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

##### *Neni 11*

##### *Kompetencat*

*Administratori ka te drejte e detyrohet te :*

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- 9) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shpendarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;

d) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;

dh) kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;

e) raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaqme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

Administratori eshte i detyruar te therrase mbledhjen e asamblese se pergjithshme edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara,

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem.

Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te tretteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

## Neni 12

### Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te tretteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja e Pergjithshme qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka here marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me pergjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim;
- 9) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave

personale me ata te shoqerise;

d) te ushtrroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per c;do veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Nese administratori vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare. Ne menyre te vec;ante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundersiztim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e meposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shpemandan aktivet shoqerise;
- c) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

#### *Neni 13*

##### *Viti Financiar*

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Me perjashtim te vitit te pare financiar qe fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### *Neni 4*

##### *Bilanci i shoqerise dhe dividendet*

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Pergjithsme, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve te shoqerise vendos rreth shpendarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, sic; edhe parashikohet nga ligji.

#### *Neni 15*

##### *Ekspertet*

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, ate gjithvejtor dhe ate ne lidhje me kontrollat periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e asamblese se pergjithshme.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollat periodike te

ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe asamblese se pergjithshme per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

#### Neni 16

Te ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi , Asamblese se shoqerise. Te cilat mund te kalojne dhe per zmadhimin e kapitalit .

#### Neni 17

*Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne c;do kohe :*

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- 9) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Asambleja e Pergjithshme merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne 9do dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emeratesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga Asambleja e Pergjithshme.

Nese Asambleja e Pergjithshme nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likujdues.

#### Neni 18

Likujduesi merr persiper te drejatat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Nese shoqeria emerion me shume se nje likuidues, perveçse kur akti i emerimit parashikon se ata veprojne veçmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojne bashkerisht te drejatat e detyrimet sipas ketij ligji. Likujduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryeje veprime te nje kategorie te posaçme.

Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit. Likujduesi u nenshtrohet mbikeqyrjes se ortakeve dhe administratorit.

#### Neni 19

##### Te drejatat e detyrimet e likujduesit

1. Detyra e likujduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
2. Likujduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar.
3. Nese, ne haze te padive te ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta

pezullojne proceduren e likuidimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e proçedurave te falimentimit.

Likuiduesi pergatit nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne 9astin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne çastin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te shoqerise. Bilancet ne shoqerine kolektive dhe komandite miratohen nga ortaket e tjere, ndersa ne shoqerite aksionare apo nga ato me pergjegjesi te kufizuar miratohen nga asambleja e pergjithshme.

#### Neni 20

##### Perfundimi i likuidimit

Pas shpemdarrjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon çregjistrimin e shoqerise, ne perputhje me seksionin V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"

#### Neni 21

##### Bashkimi

Dy ose me shume shoqeri mund te bashkohen nepermjet:

1. Kalimit te te gjitha aktiveve e pasiveve te njeres ose me shume prej shoqerive, qe quhen shoqerite e perthithura, te nje shoqeri tjetere ekzistuese, e quajtur shoqeria perthithese, ne kembim te aksioneve apo kuotave te kesaj shoqerie. Ky proces quhet bashkim me perthithje.
2. Themelimit te nje shoqerie te re, tek e cila kalohen te gjitha aktivet e pasivet e shoqerive ekzistuese, qe bashkohen ne kembim te aksioneve apo kuotave te shoqerise se re. Ky proces quhet bashkim me krijim i nje shoqerie te re.

#### Neni

##### 22

##### Ndarja

Nje shoqeri mund te ndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme, duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume shoqerive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqeria qe ndahet, vleresohet e prishur.

Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri ne 225 te ligjit 9901 date 14.04.2008.

Shoqerite, qe fitojne pasurite e shoqerise qe ndahet, quhen shoqeri pritese dhe pergjigjen ne menyre solidare per detyrimet e kesaj te fundit.

Regjistrimi i ndarjes se shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ka si pasoje kalimin te shoqerite pritese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe ndahet, ne perputhje me raportin e ndarjes, te percaktuar ne marreveshjen e ndarjes.

Ky kalim sjell pasoja per marredheniet ndermjet shoqerive, si dhe per palet e treta; berjen e aksionareve/ortakeve te shoqerise qe ndahet aksionare apo ortake te nje ose me shume shoqerive pritese, ne perputhje me raportin e ndarjes, percaktuar ne marreveshjen e ndarjes; vleresimin e shoqerise qe ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, sipas seksionit V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

#### Neni 23

##### Shnderrimi



Shoqeria mund ta ndryshoje formen e vet ligjore, nepermjet shnderrimit te saj ne shoqeri aksionare.

Shnderrimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrimet, qe shoqeria ka marre persiper ndaj te treteve.

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 25

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per c;do mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.


Neni 26

Dispozita perfundimtare


Ky Statut u redaktua ne 4 kopje me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe, dhe pasi iu lexua ortakeve themeltar te shoqerise, nenshkruhet me vullnetin e tyre te lire nga ortaket themelues.

**ORTAKET THEMELUES**

1. Eneo GJATA 2. Enzo MATTA



3. Sadik BULBUL



4. Orhan ISIKLI

